

BIBLIOTEKA
SHTETIT

LH-1
R 91

LLAMBRO
RUCI

MES
NJERËZVE
poezi

8448
REI



80462
14.8.94

LLAMBRO
RUCI

MES
NJERËZVE
poezi

53

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

X

PARTISË

Vë zemrën në rrähjen e ngrohtë të zemrave,
në prehrin e pragjeve e maleve,
te tingulli i metalit dhe gurgullima e ujërave;
vë syrin në dritën e ditëve,
në kaltërsinë e peizazhet e rinj,
në lodrat e stërkalave që buisin turbinave
si lulet në ditën e parë të pranverës;
vë gjoksin në qëndresën e gurtë të atdheut
dhe ndiej gjakun e zemrave,
përjetësinë e pragjeve,
të qeshurën e dritës:
emrin tënd, Parti.

Pa ty dita s'do të ish ditë
po një mjegull e hirtë e përjetshme,
pa ty njeriu s'do ish njeri
po rob i mushkonjave, i gjakmarrjes,
i përmbytjeve, i kërbaçit...

Vë zemrën në rrahjen e zemrave e krismën e
këngëve,
në rrënjet e jetës
dhe ndiej gjakun tënd të vërshojë, Parti,
të na zgjojë mendimet e horizontet me krahë
shqiponje
për nënën Shqipëri...

NYJA JETE

NAIMIT

Në qiellin e ditëve tonë
ndrit dhe qiriri naimjan
si yll i bukur, i afërt,
i ngrohtë e plot mall.

Një yll që na rrëfen
majat e blerta me lisat e gjatë
që fëshfërijnë ninulla të ëmbla
me manushaqet rrëth e qark.

Një yll që na ngroh në rremba
dashurinë për dhenë tënë,
për fushat, gërxhet e bregoret,
për lulet, Shqipërinë e shtrenjtë.

Ja si shfaqet e gjallë
përjetësia njerëzore,
si yll që çunave u nxë
gjuhën e nënës shkronjë pas shkronje.

NDERIM PËR SHOKUN

Na iku një shok dhe na la në zemra
fytyrën e tij të veshur me dritë,
mîrësitë në punë e biseda,
qeshjen e çiltër te sytë.

E marrim kujtimin e tij-syth këngë
për të zbutur dhimbën që na bren,
për të mbrujtur èndrrat e lëna përgjysmë
si një fidan ndanë rrugës mbjellë.

Kështu vazhdim të njëri-tjetrit
në fusha e transhe veten e ndiejmë,
rrugën dhe mendimin e bukur të shokut
kurrë përgjysmë s'i lemë.

PERËNDIM NË SKELË

Dielli i plotë mbi Sazan
është syri i ditës që do vijë.
Deti me brigjet mërmërit
një grishje e një ëndërrim.

Dhe vjen pranë një zë i ngrohtë,
vijnë dy duar të buta...
Era valët i zbardh një nga një
tek shtyhen si dele të urta.

Në një mbrëmje të tillë s'mund të hesht.
S'mund të heshtësh asnjë çast,
mos qofsh poet, njeri do të jesh:
në ndjefsh gjakun aortën të godasë,

dhe dashurinë të vërshojë paprerë
si valë e kaltër tej e tej.
T'ia ndiesh atdheut madhështinë,
në një bisk ulliri, në një themel...

BERAT, 1455

Një lulëkuqe majë bedenash
dhe fjalët e një luftëtari rënë nën të:
«Mos fli kurrë! Shkujdesja si fashë e errët
na zuri sytë.
Pastaj ç'mbeti, tradhtia i shqeu,
një lumë gjaku dhe të vrarët përbys.

Mos i zer besë kurrë qetësisë së rrreme,
armikut që tërë jetën ka menduar të të mbysë
dhe në vend të qiellit të kaltër
bari i harresës të të mbijë tek sytë.

Në çdo gjë që thonë, në çdo gjë që bëjnë
është mandata, është helmi
që përvëlon polenin e luleve dhe vazhdimësinë
endur me nyja gjaku brez më brez.

Mos i zër besë fjalës dhe «nderit» të të
shiturve
që armikut i shtrojnë udhët e pragjeve:
s'mjafton mallkimi për ta, po kokrra e plumbit
dhe presa e një mijë hakmarrjeve.»